

TLAS



Shërbimi Ligjor Falas Tiranë


Gazeta TLAS

Botim i Shërbimit Ligjor Falas Tiranë

Nr.1

2008

NUMRI TOTAL I ÇESHTJEVE NE VITE
1 Janar 1999 - 31 Dhjetor 2007



Botimi i këtij materiali është mbështetur financiarisht nga programi i granteve të vogla i Komisionit për Demokraci i Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Tiranë. Mendimet dhe opinionet e shprehura në këtë material nuk paraqesin domosdoshmërisht ato të Departamentit të Shtetit.

Të nderuar përfitues e klientë të TLAS, partnerë, anëtarë të stafit, studentë e bashkëpunorë,

Me lejon t'ju uroj punë të mbarë, suksese dhe gjithë të mirat për vitin 2008!

Viti 2007 ka qënë një nga vitet më të begatë për të gjithë përfituesit e TLAS, ka qënë një vit i mbushur me kënaqësi, me vështirësi dhe arritje si në numrin e klientëve që kanë përfituar shërbime edhe në fushën e ndërgjegjësimit të shtresave vulnerabël përmes aktiviteteve intensive të "Street Law". Tabelat në këtë botim flasin sa efektiv mund të jetë një staf punonjësish edhe pse i kufizuar në numër, kur punon me përkushtim e pasion.

Një nga sukseset më të mëdha të TLAS për 2007, konsiderohet puna e filluar për Draftimin e Ligjit Shqiptar për Ndhmën Ligjore ku vlen të përmendet puna shumë serioze dhe cilësore e ekspertëve të TLAS. Për këtë do doja në mënyrë të vecantë të falenderoja Ministrinë e Drejtësisë, e cila rekomandoi dhe i besoi TLAS, si njësi implemmentuese, të zbatojë një projekt kaq të rëndësishëm për rritjen aksesit në drejtësi të shtetasve shqiptarë.

Botimi Draftit në këtë numër të gazetës së TLAS, do t'i japi mundësi edhe bashkëpunorëve të tjerë të japin opinionet e tyre të vlefshme për një ligj që pretendon të ndihmojë aksesin në drejtësi të shtresave në nevojë. Sigurisht drafti ka kohë që është shpërndarë për të thithur komente nga ekspertë të vendit dhe të huaj, nga strukturat shtetërore dhe OJF& partnerë të tjerë të fushës. Prandaj kam rastin të përshëndes në mënyrë të vecantë ndihmën profesionale që ekspertë të Euraliusit në Tiranë, Këshillit të Europës në Strasburg, Klinikës së të Miturve në Tiranë, UNICEF, Greater Legal Aid

Boston, me kanë dhënë për përmirësimin e draftit. Botimi i draftit në këtë gazetë, do t'i japi mundësi edhe bashkëpunëtorëve të tjerë të japin opinionet e tyre të vlefshme për një ligj që pretendon të hap dyert e të ndihmojë aksesin në drejtësi të shtresave në nevojë.

Stafi i TLAS shpreh falenderimet më të përzemërta për Bordin e tij Drejtues që në vitin e parë të independencës si OJF lokale, e ka ndihmuar e mbështetur me profesionalizmin vizionin e tij konstruktiv.

Pa mbështetjen e Donatorëve të nderuar të TLAS si CAFOD, UNICEF, SHC, SOROS, US Embassy, TdH, etj nuk do të mund të realizohej programi i TLAS për 2007, prandaj dhe përpjekjet në rritje të TLAS demonstrojnë falenderim dhe respekt për të gjithë ata që kontribuojnë në financimin e projekteve në dobi të shtresave vulnerabël.

Me respekt,
Rajmonda BOZO
Drejtore Ekzekutive e TLAS





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI**

PROJEKTLIGJ

Nr. _____, datë _____

“PËR NDIHMËN JURIDIKE”

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

**Neni 1
Objekti i ligjit**

Ky ligj përcakton kushtet, llojin, mënyrën dhe procedurat për dhënien e ndihmës juridike nga shteti me qëllim mbrojtjen e lirive dhe të drejtave themelore të individit, si dhe interesat e tjera të ligjshme të tij.

**Neni 2
Parimet themelore të ndihmës juridike**

Dhënia e ndihmës juridike nga shteti për individët mbështetet në parimet e më-

poshtme:

- a) barazia e të drejtave për të gjithë individët që përfitojnë nga ndihma juridike;
- b) profesionalizmi i personave që japin ndihmën juridike;
- c) cilësia, efikasiteti dhe efektiviteti i shërbimit të ndihmës juridike;
- d) ruajtja e konfidentalitetit;
- e) papranueshmëria e konfliktit të interesit në dhënien e ndihmës juridike.

KREU II ADMINISTRIMI I SHËRBIMIT TË NDIHMËS JURIDIKE

Neni 3 Administrimi

Shërbimi i ndihmës juridike të dhënë nga shteti për individët është përgjegjësi e Ministrisë së Drejtësisë, Dhomës Kombëtare të Avokatisë dhe Komisionit Shtetëror për Ndhmën Juridike.

Neni 4 Detyrat e Ministrisë së Drejtësisë

Ministria e Drejtësisë, në shërbimin e ndihmës juridike për individët, kryen këto detyra:

- a) zhvillon politikën shtetërore në fushën e ndihmës juridike shtetërore për individët;
- b) ndihmon në përgatitjen e akteve të nevojshme ligjore/nënligjore, në bashkëpunim me Dhomën Kombëtare të Avokatisë dhe Komisionin Shtetëror për Ndhmën Juridike, në fushën e shërbimit të ndihmës juridike;
- c) kujdeset për zbatimin e dispozitave ligjore dhe nënligjore për ndihmën juridike shtetërore dhe ndihmon në vlerësimin e cilësinë e ndihmës juridike të dhënë;
- d) përgatit projektbuxhetin për ndihmën juridike shtetërore, në përputhje me legjislacionin në fuqi; dh) kryen detyra të tjera të parashikuara në ligj.

Neni 5 **Detyrat e Dhomës Kombëtare të Avokatisë**

Dhoma Kombëtare e Avokatisë, në shërbimin e ndihmës juridike për individët, kryen këto detyra:

- a) merr pjesë në përcaktimin e kritereve për përzgjedhjen e avokatëve që do të japin ndihmën juridike për individët sipas këtij ligji;
- b) merr pjesë në përcaktimin e kritereve për vlerësimin e cilësisë së shërbimit të dhënë nga avokatët për ndihmën ligjore, sipas këtij ligji;
- c) merr masa disiplinore ndaj avokatëve sipas ligjit "Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë";
- d) kryen funksione të tjera të parashikuara në ligj.

Neni 6 **Komisioni Shtetëror për Ndihmën Juridike**

1. Komisioni Shtetëror për Ndihmën Juridike është organ shtetëror kolegjal dhe ka statusin e personit juridik publik.

2. Komisioni përbëhet nga 5 anëtarë. Një anëtar zgjidhet nga Ministri i Drejtësisë, një anëtar nga Ministri i Financave, një anëtar nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë, një anëtar nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë dhe një anëtar nga organizatat jofitimprurëse që veprojnë në fushën e ndihmës ligjore. Anëtari për organizatat jofitimprurëse zgjidhet nga 4 anëtarët e zgjedhur si më sipër, nga lista e kandidatëve të propozuar nga organizatat jofitimprurëse që veprojnë në fushën e ndihmës ligjore.

3. Mandati i anëtarëve të Komisionit është 4 vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje të menjëhershme vetëm një herë.

4. Komisioni është organ kolegjal me kohë të pjesshme, më përjashtim të Kryetarit i cili është funksionar me kohë të plotë.

5. Asistenca teknike, logjistike dhe financiare sigurohet nga Sekretariati i Komisionit.

6. Komisioni organizohet dhe funksionon sipas Rregullores së Brendshme që miratohet nga Ministri i Drejtësisë.

7. Paga e kryetarit të Komisionit dhe shpërblimi i anëtarëve të tij përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave. Struktura, organika dhe niveli i pagave të Sekretariatit të Komisionit përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 7

Kushtet për t'u zgjedhur anëtar i Komisionit dhe kryetari

1. Anëtar i Komisionit mund të zgjidhet personi që:

- a) ka shtetësi shqiptare;
- b) ka zotësi të plotë për të vepruar;
- c) ka mbaruar arsimin e lartë juridik ose ekonomik;
- d) gëzon një figurë të pastër morale dhe përgatitje të lartë profesionale.
- e) ka një përvojë jo më pak se 5 vjet në profesion.

2. Kryetari i Komisionit emërohet në detyrë me urdhër të përbashkët të Ministrit të Drejtësisë dhe Ministrit të Financave, pasi është marrë më parë mendimi i Kryesisë së Dhomës Kombëtare të Avokatisë.

3. Kryetari i Komisionit lirohet nga detyra me urdhër të përbashkët të Ministrit të Drejtësisë dhe Ministrit të Financave, me propozim të Kryesisë së Dhomës Kombëtare të Avokatisë.

Neni 8

Lirimi i anëtarëve të Komisionit

Lirimi nga detyra i anëtarit të Komisionit Shtetëror për Ndhmën Juridike, bëhet nga organi që ka emëruar anëtarin në këto raste:

- a) jep dorëheqjen;
- b) mbush moshën e pensionit;
- c) dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë;
- d) ndërpret marrdhëniet e punës me insitucionin që e ka emëruar.
- e) nuk merr pjesë pa arsye në më shumë se tre mbledhje rresht të Komisionit.
- f) i mbaron mandati i qëndrimit në detyrë.

Neni 9 **Fuqia detyruese e vendimeve**

Vendimet e marra nga Komisioni Shtetëror për Ndihmën Juridike janë detyruese për zbatim nga avokatët që japin ndihmën juridike sipas këtij ligji. Në rast të moszbatimit të tyre Komisioni ka të drejtë të kërkojë marrjen e masave disiplinore ndaj avokatëve sipas ligjit "Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë".

Neni 10 **Detyrat e Komisionit**

Komisioni Shtetëror për Ndihmën Juridike kryen këto detyra:

- a) zbaton politikën shtetërore në dhënien e ndihmës juridike për individët sipas këtij ligji;
- b) menaxhon buxhetin e akorduar për qëllim të ofrimit të ndihmës juridike nga shteti;
- c) miraton rregullat e caktimit të avokatëve që do të ofrojnë ndihmën juridike dhe kujdeset për zbatimin e tyre;
- d) Vlerëson kostot dhe planifikon shpenzimet në lidhje me ofrimin nga ana e shtetit të ndihmës juridike dhe ia paraqet Ministrit të Drejtësisë, për t'u përfshirë në buxhetin e shtetit;
- e) lidh kontratat e shërbimit me avokatët që do të ofrojnë shërbimin e ndihmës juridike.
- e) Vendos masën e shpërblimit që përfitojnë avokatët në ofrimin e ndihmës shtetërore ndaj individëve, pasi të këtë marrë më parë mendimin e Ministrit të Financave dhe Ministrit të Drejtësisë, por në cdo rast jo më të vogla se tarifat e miratuara për shërbimin e avokatisë nga Ministri i Financave dhe Ministri i Drejtësisë;
- f) paraqet raportin vjetor para Ministrit të Drejtësisë dhe Ministrit të Financave në fund të cdo viti, si dhe raporton sa herë që i kërkohet.
- g) vendos dhe rishikon standartet e ndihmës juridike, si dhe kujdeset për trainimet profesionale për avokatët që japin ndihmën juridike.
- h) bashkëpunon me organizatat ndërkombëtare dhe organizata jofitimprurëse, vendase ose të huaja, që veprojnë në fushën e ndihmës ligjore;
- i) vendos kriteret mbi bazën e të cilave do të bëhet vlerësimi i cilësisë së shërbimit të ndihmës juridike të dhënë;

- j) mban të dhënat për personat që përfitojnë ndihmën juridike dhe boton në fund të çdo viti buletinin statistikor për to.
- k) merr vendim dhe urdhëron kryerjen e pagesës së avokatëve për dhënien e ndihmës juridike, pas paraqitjes së dokumenteve që përcaktohen me vendim të vecantë të tij.
- l) cakton përparësitë lidhur me llojet e çështjeve për të cilat ofrohet ndihmë juridike me kufizimet e imponuara për shkak të burimeve dhe mjeteve financiare në dispozicion;
- ll) bashkërendon sistemin e ndihmës juridike, duke përfshirë ofrimin e ndihmës juridike në të gjitha format;
- m) kryen detyra të tjera të parashikuara në ligj.

KREU III
SHËRBIMET E NDIHMËS JURIDIKE DHE PËRFITUESIT E SAJ

Neni 11
Ndihma juridike dhe përfituesit e saj

1. Ndihma juridike e dhënë nga shteti jepet nga avokatët e autorizuar sipas këtij ligji, në kushtet e përcaktuara në këtë ligj dhe në formën e ndihmës juridike parësore dhe ndihmës juridike dytësore.

Ndihma juridike dytësore është dhënia e shërbimeve të këshillimit, përfaqësimit apo mbrojtjes në proceset gjyqësore penale, proceset gjyqësore civile, si dhe paraqitjes para organeve administrative shtetërore.

Ndihma juridike parësore është dhënia e informacionit për sistemin ligjor në Republikën e Shqipërisë, aktet normative në fuqi, të drejtat dhe detyrimet e subjekteve të ligjit, mënyrat e ushtrimit të të drejtave të individit, në proceset gjyqësore dhe ato jashtëgjyqësore, asistencë në hartimin e dokumenteve juridike apo në forma të tjera që nuk përbëjnë ndihmë juridike parësore.

2. Ndihma juridike jepet edhe nëpërmjet edukimit ligjor të publikut përmes ndihmës që i ofrohet komunitetit me klinika lëvizëse, publikime, fushatave televizive dhe në median vizive si dhe masa të tjera të ngjashme, duke u kushtuar vëmendje të veçantë nevojave të grupeve më në nevojë.

Neni 12 **Format e dhënies së ndihmës juridike**

Ndihma juridike jepet nëpërmjet:

- a) sigurimit të informacionit, dhënies së këshillimeve dhe shpjegimeve të çështjeve juridike nëpërmjet intervistave të drejtëpërdrejta apo komunikimit në distancë,
- b) plotësimi i akteve juridike;
- c) këshillimi në vazhdimësi i personave që paraqiten vetë në gjykatë (clinic);
- d) përfaqësimit para organeve administrative;
- dh) mbrojtja e interesave të të dyshuarit, të akuzuarit dhe mbrojtësit në procesin penal;
- e) mbrojtja dhe përfaqësimi i interesave të një personi në procesin penal.
- ë) mbrojtja dhe përfaqësimi i interesave të personave në çështjet civile ose administrative;

Neni 13 **Personat që kanë të drejtë të përfitojnë ndihmën juridike**

1. Të drejtën për të përfituar ndihmë juridike e kanë individët të cilët:

- a) kërkojnë të mbrohen me avokat në procesin penal, në të gjitha fazat e tij, dhe për shkak të mundësive financiare nuk kanë mundur të zgjedhin një avokat apo kanë mbetur pa të.
- b) kanë nevojë për ndihmë juridike në çështjet civile ose administrative, por nuk kanë mjete të mjaftueshme për të paguar këtë ndihmë juridike apo çështjet janë tepër komplekse nga ana e përmbajtjes dhe procesi durës. Në këtë rast personi që të përfitojë ndihmë juridike duhet të vërtetojë se merr asistencë sociale ose plotëson kushtet për përfitimin e saj.

2. Ndihmën juridike e përfitojnë edhe të miturit, për të cilët mbrojtja në procedimin penal dhe në gjykim është e detyrueshme me ligj.

3. Ndihma juridike mund të kërkohej para dhe gjatë zhvillimit të seancave

gjyqësore.

4. Personi që përfiton ndihmën juridike ka detyrimin të bashkëpunojë me avokatin që siguron ndihmën juridike, të japë informacion të vërtetë për të cilin është kërkuar ndihma juridike, si dhe t'i sigurojë në kohë çdo informacion të rrethanave dhe kushteve që kanë ndryshuar shkakun e dhënies së ndihmës ligjore.

5. Moszbatimi i pikës 4 të këtij neni nga individit që përfiton ndihmën juridike për çështjet civile ose administrative përbën shkak për ndërprerjen e përfitimit të mëtejshëm të ndihmës juridike.

Neni 14

Rimbursimi i shpenzimeve për dhënien e ndihmës juridike

1. Në rast se përfituesi i ndihmës juridike, në përfundim të proçesit gjyqësor përfiton rimbursimin e shpenzimeve gjyqësore të parapaguara, ai detyrohet të rimbursojë Komisioni Shtetëror për shpenzimet e kryera nga ky i fundit për ofrimin e ndihmës në çështjen perkatëse.

2. Personi që ka përfituar ndihmë juridike duke paraqitur të dhëna të rreme ose të pavërteta, përfshirë edhe të dhënat për gjëndjen e tij financiare, është i detyruar të rimbursojë të gjithë shpenzimet e kryera për ofrimin e kësaj ndihme.

3. Rimbursimi i shpenzimeve sipas pikës 2 të këtij neni behet sipas urdhërit të lëshuar nga Kryetari i Komisionit për Ndihmën Shtetërore. Urdhëri i Kryetarit të Komisionit është titull ekzekutiv dhe ngarkohet Sherbimi i Permbarimit gjyqësor me ekzekutimin e tij.

Neni 15

Refuzimi për dhënien e ndihmës juridike

1. Dhenia e ndihmës juridike në çështjet civile dhe administrative jepet duke mbajtur parasysh:

- a) suksesin në zgjidhjen e çështjes dhe/ose vlerën relative të ankesës apo pasurisë së përfshirë;
- b) arsyeshmërinë e argumenteve ligjore të cilat paraqiten në emër të kërkuarit apo përfituesit dhe bazueshmërinë e tyre

- c) në ligj;
 - d) mundësinë e suksesit të ankesës apo të mbrojtjes;
 - e) kompleksitetin e çështjes; dhe
 - f) aftësinë e kërkuesit apo përfituesit që të vetëpërfaqësohen.
2. Dhenia e ndihmes juridike nuk refuzohet ne çështjet penale parashikuar nga neni 13, pika 1 te ketij ligji.

KREU IV PROÇEDURA PËR DHËNIEN E NDIHMËS JURIDIKE

Neni 16 **Paraqitja e kërkesës**

1. Kërkesa për dhënie e ndihmës juridike në formën e përfaqësimit në gjykatë për një çështje civile ose administrative duhet të paraqitet personalisht nga kërkuesi apo përfaqësuesi i tij, i autorizuar me prokurë. Formulari i kërkesës dhe dokumentat shoqëruese të tij përcaktohen me vendim të Komisionit Shtetëror për Ndihmën Juridike.

2. Kërkesa për dhënie e ndihmës juridike në format e tjera të parashikuara nga neni 12 i këtij ligji nuk i nënshtrohet asnjë forme; ajo mund të paraqitet edhe verbalisht tek personi i autorizuar për dhënie e ndihmës apo për caktimin e ofruesit të ndihmës.

3. Rregullat për paraqitjen e kërkesave verbale dhe personi (fizik ose juridik) pranë të cilit paraqitet kërkesa përcaktohen nga Komisioni Shtetëror i Ndihmës Juridike.

Neni 17 **Shqyrtimi/refuzimi i kërkesës**

1. Organi që ka të drejtën e refuzimit të ndihmës juridike është Kryetari i Komisionit Shtetëror të Ndihmës Juridike.

2. Kundër vendimit të refuzimit të dhënies së ndihmës juridike mund të bëhet ankim në gjykatën e rrethit ku ka vendbanimin kërkuesi sipas dispozitave ligjore të kundërshtimit të aktit administrativ.

Neni 18

Vendimi i refuzimit të dhënies së ndihmës juridike

1. Vendimi për refuzimin e dhënies së ndihmës juridike duhet të përmbajë:

- a) datën dhe vendin e vendimit;
- b) emrin dhe mbiemrin e kërkuesit;
- c) formën e ndihmës juridike të kërkuar;
- d) arsyet e refuzimit të dhënies së ndihmës juridike;
- e) procedurën e ankimit.
- f) të dhëna të tjera të nevojshme.

2. Avokati i caktuar për të dhënë ndihmën juridike mund të zëvendësohet në:

- a) rastin e paraqitjes së kërkesës me shkrim nga kërkuesi për zëvendësimin e tij;
- b) me kërkesë të avokatit të caktuar të japë ndihmën juridike;
- c) në rast të konfliktit të interesit.

Neni 19

Bashkëpunimi me organizatat jofitimprurëse

1. Organizatat jofitimprurëse të specializuara në fushën e dhënies së ndihmës juridike kanë të drejtë të japin ndihmë juridike me avokatë, duke respektuar përcaktimet e bëra në këtë ligj.

2. Komisioni Shtetëror për Ndihmën Juridike harton kontrata bashkëpunimi me këto organizata për të mundësuar dhënien e ndihmës juridike, në përputhje me format dhe kushtet e parashikuara nga ky ligj.

Neni 20

Avokatët që japin ndihmën juridike

1. Ndihma juridike parësore dhe ndihma juridike dytësore jepet vetëm nga personat që ushtrojnë profesionin e avokatit.

2. Dhoma Kombëtare e Avokatisë dhe Komisioni Shtetëror për Ndihmën Juridike përcaktojnë listën e avokatëve që autorizohen, në përputhje me këtë ligj, të japin ndihmën juridike si dhe vendin e shtrirjes së veprimtarisë së tyre. Nëse është e

nevojshme Komisioni dhe Dhoma Kombëtare e Avokatisë mund të organizojnë konkurs për përcaktimin e avokatëve që japin ndihmë juridike.

3. Lista e avokatëve që autorizohen të japin ndihmë juridike bëhet publike.

Neni 21

Kontrolli i cilësisë së ndihmës juridike

1. Kontrolli i cilësisë së ndihmës juridike të ofruar realizohet nga Komisioni Shtetëror për Ndihmën Juridike. Me kërkesë të të interesuarit, kryesisht apo kërkesë të Ministrit të Drejtësisë, Komisioni duhet të verifikojë dhe kontrollojë cilësinë e ndihmës juridike në një rast konkret dhe në bazë të rezultateve ka të drejtë të zgjidhë kontratën e shërbimit me avokatin për dhënien e ndihmës juridike.

2. Forma dhe standartet e kontrollit miratohen me vendim të Komisionit Shtetëror për Ndihmën Juridike.

3. Rezultatet e kontrollit i dërgohen Dhomës Kombëtare të Avokatisë dhe mund të shërbejnë si bazë për marrjen e masave disiplinore ndaj avokatëve.

KREU V DISPOZITA TE FUNDIT

Neni 22

Buxheti

1. Dhënia e ndihmës juridike në formën e ndihmës juridike parësore dhe ndihmës juridike dytësore përballohet nga buxheti i shtetit.

2. Fondet për dhënien e ndihmës juridike përbëjnë zë të vecantë në buxhetin e Komisionit Shtetëror për Ndihmën Juridike.

Neni 23

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 3 muaj pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Kryetare

Jozefina TOPALLI

E DREJTA JUAJ PËR T'U INFORMUAR

Edrejta juaj për t'u informuar përbën një të drejtë kushtetuese. Kjo e drejtë parashikohet në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe rregullohet nga ligji Nr.8503 datë 30.06.1999 "Për të drejtën e informimit mbi dokumentet zyrtare".


E drejta për t'u informuar është thelbësore për funksionimin dhe zhvillimin e demokracisë. Nëpërmjet kësaj së drejte çdo qytetar kërkon që Qeverisja të

jetë sa më e hapur dhe transparente, të japë llogari përpara qytetarëve, të cilëve duhet t'u shërbejë.

Kjo e drejtë krijon mundësinë që çdokush të marrë informacion lidhur me interesat vetjakë dhe familjarë, me mënyrën se si shpenzohen fondet publike, për shërbimet publike që duhet të përfitojnë etj.

Çdo qytetar ka të drejtë të kërkojë informacion për dokumentat zyrtare që kanë të bëjnë me veprimtarinë e organeve shtetërore dhe të personave që ushtrojnë funksione shtetërore, pa qenë i detyruar të shpjegojë motivet. Organe të administratës shtetërore ku mund të drejtohet për informacion qytetari janë organet e pushtetit qendror, vendor dhe organet e forcave të armatosura. Entet publike janë organe joshtetërore të krijuara me ligj për realizimin e një interesi publik.

Informacioni që organi shtetëror është i detyruar të bëjë publik për të lehtësuar informimin e publikut janë si më poshtë:



1. Vendndodhjen e organeve qendrore dhe vendore, si dhe emrat e punonjësve nga të cilët publiku mund të marrë informacion;

2. Rregullat, procedurat dhe mënyrat sesi mund të merret informacioni apo formularët e ndryshëm;

3. Rregullat në bazë të të cilave vepron autoriteti publik;

4. Procedurat e punës së autoritetit publik.

Krahas këtyre informacioneve çdo organ publik duhet të ketë të përgatitura paraprakisht:

- Vendimet përfundimtare për një çështje të caktuar, që përfshijnë vendimet e pakicës dhe urdhrat e udhëzimet në zbatim të tyre;
- Rregullat e brëndshme që ndikojnë në marrëdhëniet me publikun;
- Kopje të dokumentit zyrtar që i është dhënë më parë një personi tjetër dhe që mund të jenë me interes për persona të tjerë;



- Indeksin apo skedarët e dokumenteve zyrtare.

Si duhet të kërkohet informacion në institucion

Çdo qytetar në mungesë të një formulari të posaçëm duhet të paraqes me shkrim kërkesën për informacion e cila duhet të përmbajë:

- organin administrativ që i drejtohet;
- emrin dhe adresën e kërkuarit;
- shpjegimin për informacionin që kërkohet;
- datën e kërkesës dhe firmën.

Të gjithë autoritetet publike duhet të nxjerrin rregullore dhe



të krijojnë lehtësi strukturore e praktike për marrjen në mënyrë të saktë, të plotë, të përshtatshme e të shpejtë të informacionit për dokumentet zyrtare. Autoriteti nuk mund të japë informacion mbi të dhënat personale të individëve, me përjashtim të rasteve kur subjekti i këtyre të dhënave jep pëlqimin e tij paraprakisht dhe shprehimisht. Por ekzistojnë edhe disa përjashtime kur ky informacion mund të jepet pa pëlqimin e vetë subjektit siç është e drejta për tu njohur me deklaratën e pasurisë që bëjnë zyrtarët e lartë të shtetit sipas ligjit. Rastet përjashtimore ku organ i administratës publike mund të mos pranojë kërkesën për infor-

macion, janë atëhere ku informacioni i kërkuar për një dokument zyrtar kufizohet me ligj, si p.sh:

- informacion që lidhet me sigurinë kombëtare,
- informacion mbi të dhënat vetjake,
- informacion mbi veprimtarinë e policisë dhe atë gjyqësore
- informacion mbi sekretin tregtar

Edhe në këto raste organi i administratës shtetërore duhet të lëshojë një deklaratë me shkrim, në të cilën tregohen arsyet e mosdhënies së informacionit dhe rregullat në bazë të cilave mund të kërkohet ky informacion.

Afati për përgjigjen e kërkesës për informacion

Organi i administratës publike si rregull duhet të plotësojë dhe ti përgjigjet kërkesës brenda 40 ditëve nga depozitimi i saj. Kur organ i administratës refuzon kërkesën për informacion duhet të japë një përgjigje me shkrim

dhe të arsyetuar për shkaqet e refuzimit të kërkesës.

Në rastin kur organi i administratës e ka të pamundur plotësimin brenda këtij afati, atëherë, organi i administratës publike duhet të njoftojë me shkrim, jo më vonë se 7 ditë nga mbarimi i afatit të mëparshëm, për pamundësinë e realizimit të pjesëshëm ose të plotë të kërkesës për informim, si dhe arsyet ose shkaqet që e kanë sjellë atë.

Organi i administratës publike në rast se kërkon të shtyrë afatin për dhënien e përgjigjes më shumë se 10 ditë duhet të bie dakord me qytetarin që ka bërë kërkesën për informacion.

Për kryerjen e shërbimit të informimit për dokumentet zyrtare, organi i administratës publike mund të vendosë tarifa. Këto tarifat duhet të bëhen publike.

E drejta e ankimit

Çdo qytetar ka të drejtë të ankohet në rrugë administrative në rast se mendon se i janë shkelur të drejtat e parashikuara nga ky ligj. Në rast se qytetari nuk merr përgjigje ose nuk është i kënaqur



me përgjigjen që ka marrë nga organi i administratës publike për kërkesën e tij ai mund të ankohet të titullari i këtij organi në rrugë administrative, duke pretenduar morespektimin e ligjit.

Në rast se kërkesa ndaj titullarit nuk shqyrtohet sipas ligjit, qytetari ka të drejtë të ankohet në gjykatë, në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative dhe Kodin e Procedurave Civile.

Përveç rrugës administrative dhe gjyqësore, çdo qytetar ka të drejtë t'i drejtohet Avokatit të Popullit, i cili është ngarkuar nga ligji që të kujdeset për zbatimin e ligjit për të drejtën e informimit mbi dokumentet zyrtare.

Naureda LLAGAMI
Avokate e TLAS

HISTORI E VËRTETË

Pranë Shërbimit Ligjor Falas Tiranë u paraqit klienti V. S. V.S kishte punuar për 37 vite nga ku një pjesë në kooperative bujqësore dhe një pjesë në Ndërmarrjen Bujqësore L. Kur kishte mbushur moshën për të përfituar pension V.S aplikoi në zyrat e sigurimeve shoqërore. Zyra e Sigurimeve Shoqërore i bëri të ditur që V.S mund të përfitonte vetëm pension kooperative pasi periudha e viteve që kishte punuar në Ndërmarrjen Bujqësore L nuk i njihet si

vjetërsi pune si rrjedhojë e mosverifikimit nga Drejtoria e Sigurimeve Shoqërore, pavarësisht se kjo periudhë figuronte e mbajtur në mënyrë të rregullt në librezën e punës së klientit.

V.S u ankua kundër këtij vendimi të Drejtorisë së Sigurimeve në Komisioni Qëndror të Ankimit, por edhe ky komision mbajti të njëjtin qëndrim sikurse dhe Drejtoria e Sigurimeve Shoqërore duke argumentuar se: " emri i V.S nuk del te regjistri i Ndërmarrjes Bujqësore L. dhe me numrin e tij, del emër tjetër, gjithashtu edhe tek emrat e indeksit nuk del emri i tij".

Në këto kushte klienti V.S u paraqit i pashpresë në TLAS duke kërkuar ndihmë se në ç'mënyrë ai mund të fitonte të drejtën që i ishte privuar nga kjo zyrë.

Pasi u analizua dhe studiua dosja e tij nga avokati i TLAS, u arrit në përfundim që çështja e V.S. mund të fitohet përmes rrugës gjyqësore, pasi organet e sigurimeve shoqërore në thelb refuzojnë të njohin të drejtën dhe të paguajnë e pensionit të pleqërisë (shtetëror) për shkaqe



që lidhen me rregullshmërinë e dokumentave.

Nga ana tjetër V.S ka një librezë pune të rregulltë e cila është një dokument zyrtarë me fuqi të plotë provuese përmes së cilës klienti V.S provon më së miri faktin e të qënurit në punë në periudhën e pretenduar prej tij dhe që është hedhur poshtë nga organet e sigurimeve shoqërore. Duke qene se librezë është dokument zyrtarë ajo mund të kundërshtohet vetëm për fallshitet në përputhje me nenin 253 të K.Pr.C.

Mungesa e emrit të V.S në regjistrin e Ndërmarrjes Bujqësore L nuk ka përse të rëndojë mbi klientin V.S pasi ai nuk ishte personi i cili ka patur për detyrë t'i ruajë ato informacione. Për rrjedhojë, argumenti që japin organet e sigurimeve shoqërore nuk është i bazuar si në ligj ashtu edhe në fakte, për këto arsye zyra e TLAS vlerësoi që mbrotja gjyqësisht i kësaj çështje do ta ndihmonte klientin V.S në fitimin e së drejtës së mohuar.

Naureda LLAGAMI
Avokate e TLAS

RËNDËSIA E REGJISTRIMIT TË FËMIJËVE NË GJËNDJEN CIVILE

Regjistrimi i lindjes së fëmijës në zyrën e gjëndjes civile është e drejta e parë e fëmijës, që vihet në zbatim mbas lindjes së tij dhe përfaqëson regjistrimin e tij zyrtar si shtetas, duke i siguruar atij të drejtën për të patur identitetin, emrin dhe shtetësinë e tij. Kjo gjë lidhet ngushtë me sigurimin e një sërë të drejtash të tjera shoqërore, ekonomike dhe politike.

Nëpërmjet njohjes zyrtare nga ana e shtetit, regjistrimi i siguron





fëmijës mundësi për të përfituar shërbime të ndryshme. Regjistrimi i lindjes mundëson marrjen e çertifikatës së lindjes, që do t'i lejojë fëmijës marrjen e dokumentave zyrtare të identifikimit, si karta e identitetit, pasaporta, liçenca e automjetit, etj. Nëpërmjet kësaj njohjeje zyrtare, fëmija përfiton të drejtën për arsimim, kujdes shëndetësor, punësim, martesë zyrtare, strehim, shërbime sociale, përfshirë përfitime financiare dhe pjesëmarrje në jetën politike të vendit. Regjistrimi i fëmijës, duke siguruar shpalljen e moshës,

identitetit dhe shtetësisë, e mbron fëmijën nga martesat e hershme, puna ilegale, persekutimi dhe burgosja si i ritur, rekrutimi i parakohshëm në ushtri dhe nga trafikimi.

Regjistrimi i lindjeve është domosdoshmëri edhe për shtetin. Informacioni për numrin e përgjithshëm të banorëve, i jep shtetit një burim të suksesshëm për planifikimin dhe dhënien e fondeve për zbatimin e projekteve dhe politikave shtetërore. Ky informacion është i domosdoshëm për nxjerrjen e statistikave të vazhdueshme zyrtare,

pa të cilat nuk mund të funksionojë një shtet modern.

Nga ana tjetër, regjistrimi i lindjeve krijon premisa për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe për funksionimin normal të shoqërisë.

Regjistrimi civil

Regjistrimi i lindjes është një nga detyrat e Shërbimit të Gjëndjes Civile. Ky regjistrim tregon ekzistencën e një personi, që është e domosdoshme për qëllime zyrtare, ligjore dhe statistike. Ai tregon lidhjet e tij familjare dhe mundëson pasqyrimin e ngjarjeve civile si lindja, martesa,

zgjidhja e martesës, vdekja për vetë personin dhe për regjistrimin e lindjeve të gjeneratave të ardhshme.

Çertifikata e lindjes është një dokument ligjor që i lëshohet fëmijës dhe jep informacion për të dhënat e tij si emri, mbiemri, gjinia, data dhe vendi i lindjes, emrat, adresat dhe nënshtetësitë e prindërve. Regjistrimi i lindjes dhe marrja e një çertifikate të lindjes janë dy gjëra të ndryshme, të lidhura ngushtë midis tyre.

Konventa e të Drejtave të Fëmijëve

Ndër shumë dokumenta që



kanë të bëjnë me regjistrimin e lindjes së fëmijëve, më e rëndësishmja është Konventa e të Drejtave të Fëmijës (KDF), që shërben si bazë për mandatin e UNICEF.

Neni 7 i Konventës thotë:

- Fëmija duhet të regjistrohet menjëherë mbas lindjes dhe duhet të gëzojë të drejtën për një emër, të drejtën për të marrë shtetësinë dhe mundësisht të drejtën për të njohur dhe për të gëzuar përkujdesjen e prindërve apo të prindit.
- Shtetet do të sigurojnë zbatimin e këtyre të

drejtave, në përputhje me ligjin e tyre kombëtar dhe me detyrimet e përcaktuara nga dokumentat kryesore ndërkombëtare në këtë fushë, veçanërisht në rastin kur fëmija përndryshe do të jetë pa shtetësi.

Neni 7 i Konventës pasqyron katër të drejtat themelore të fëmijëve në lidhje me regjistrimin e lindjes:

1. E drejta për regjistrim;
2. E drejta për regjistrim menjëherë mbas lindjes;
3. E drejta për një emër dhe për të njohur prindërit;
4. E drejta për shtetësi.

E drejta e parë ka të bëjë me të drejtën e çdo fëmije për t'u regjistruar. Konventa e të Drejtave të Fëmijës kujdeset për regjistrimin e të gjithë fëmijëve, pa dallim. Kjo e drejtë u është mohuar ende shumë fëmijëve, për shkak të etnisë, gjendjes ekonomike, kombësisë, etj. Kjo




ndodh si në mënyrë të drejt-përdrejtë, për shkaqe ligjore, që ndalojnë regjistrimin e personave pa shtetësi, ashtu edhe në mënyrë jo të drejtpërdrejtë, për shkak të pengesave social ekonomike. Konventa e të Drejtave të Fëmijës garanton të drejtën për jetesë, rritje dhe zhvillim të fëmijës dhe detyron shtetet të realizojnë këto të drejta.

Pika e dytë garanton të drejtën për regjistrim menjëherë mbas lindjes. Kur regjistrimi nuk bëhet menjëherë mbas lindjes, të por-salindurit mund t'i mohohet e drejta për përfitime të shërbi-meve jetike për mbijetesën, rritjen dhe zhvillimin e tyre. Po ashtu, qeveritë nuk mund të sigurojnë planifikim efikas dhe në kohë për shërbimet ndaj fëmijëve. Regjistrimi menjëherë mbas lindjes është jo vetëm një e drejtë themelore, por edhe një mjet i rëndësishëm, për të sigu-ruar të drejtat e tjera të fëmijës. Pika e tretë paraqet të drejtën për një emër dhe për të njohur prindërit dhe kërkon regjistrim të lindjes dhe lëshim të çerti-



fikatës, që duhet të përfshijë të paktën emrin e fëmijës, gjininë, datën dhe vendin e lindjes, si dhe të dhëna për prindërit. Por marrja e këtij informacioni nuk është gjithmonë i mundshëm, siç mund të jetë rasti për fëmijët e braktisur, prindërit e të cilit nuk mund të identifikohen, apo në rastet e birësimit, kur legjislacioni ndalon identifikimin e prindërve. Në këto raste, shtetet inkurajo-hen të sigurojnë sa më shumë informacion.

Pika e fundit i referohet të drejtës së të gjithë fëmijëve për një shtetësi. Kjo nuk do të thotë që fëmija merr automatikisht shtetësinë e vëndit të lindjes.



Marrja e shtetësisë varet nga ligji i çdo shteti. Megjithatë, zakonisht shtetësia merret në bazë të shtetësisë së prindërve. Në bazë të Konventës për Reduktimin e Pashtetësisë të vitit 1961, fëmijët duhet të marrin shtetësinë e shtetit ku ata kanë lindur, nëse nuk ju jepet shtetësi nga ndonjë shtet tjetër, apo nuk marrin dot shtetësinë e ndonjërit prej prindërve. Kjo konventë bën thirrje që shtetësia të jepet të paktën në bazë të njërit apo të dy parimeve të përmëndura me sipër.

Elvira DERVISHI
Këshilltare e TLAS

HISTORI E VËRTETË

L.M. trajtohet shumë keq nga bashkëshorti i saj, i cili përveçse është vazhdimisht në gjëndje të dehur, ushtron edhe dhunë mbi të. Ai nuk jep asnjë kontribut ekonomik për të mbajtur familjen dhe L.M. është e detyruar, që gjatë gjithë ditës të grumbullojë kanoçe nëpër vendet e grumbullimit të plehrave dhe me të ardhurat që nxjerr nga shitja e tyre, të sigurojë një minimum jetese. L.M. kërkon të bëjë zgjidhjen e martesës dhe të marrë kujdestarinë e vajzes së saj minorene. Duke u nisur nga kushtet shumë të vështira ekonomike të L.M. dhe niveli i ulët arsimor i saj, TLAS morri përsipër që jo vetëm të ndjekë procedurat gjyqësore të zgjidhjes së martesës, por edhe ta ndihmojë atë në grumbullimin e të gjithë dokumentacionit të nevojshëm.

Për të bërë zgjidhjen e martesës, në gjykatë duhet të paraqiten këto dokumenta:

1. Çertifikatë personale me fotografi e personit që kërkon

zgjidhjen e martesës;

2. Çertifikatë personale pa fotografi e bashkëshortit tjetër;
3. Çertifikatë martese;
4. Çertifikatë familjare;
5. Çertifikatë personale pa fotografi, e secilit prej fëmijëve nën moshën 18 vjeç, nëse çifti ka fëmijë.

L.M. morri çertifikatat e kërkuara nga zyra e gjëndjes civile, por gjatë shqyrtimit të tyre, u vu re se në çertifikatën e martesës mungonte data e martesës. Data e martesës është një nga përbërësit kryesorë të çertifikatës së martesës dhe pa këtë datë çertikata është jo e vlefshme. Mbas interesimit tonë pranë zyrës së gjëndjes civile të Njësisë Bashkiake Nr. 5, ku L.M. figuron e regjistruar, u vu re, se në të dhënat e saj në regjistrin themeltar, mungonte kjo e dhënë. Duke kontrolluar për të dhëna të tjera, pamë se ajo, sëbashku me familjen e saj, ishte transferuar në këtë njësi, në vitin 1994, nga komuna Paskuqan. Në regjistër jepej edhe numri



rendor i regjistrimit të saj të mëparshëm në regjistrat themeltarë të gjëndjes civile të komunës Paskuqan.

Mbas takimit me punonjësit e gjëndjes civile të komunës Paskuqan dhe kontrollit të regjistrimit në numrin përkatës rendor, u pa që kjo shtetase, ishte transferuar së bashku me familjen në këtë komunë, nga Yzberishi, në vitin 1988. Në regjistër gjetëm edhe numrin e regjistrimit të saj në Yzberish. Mbas disa kërkimesh, morrëm vesh që në vitin 1988, Yzberishi ishte pjesë e Kasharit. Aty ishin edhe të dhënat e Kamzës,

në atë kohë Ndërmarrje Bujqësore Shtetërore.

Për të marrë çertifikatën e plotë të martesës të L.M., duhet të drejtoheshim në zyrën e gjëndjes civile të Prefekturës së Tiranës, ku ruhet arkivi i të gjitha librave të akteve të gjëndjes civile, përfshirë ato të martesës, për rrethin e Tiranës. Por aktet ruhen në libra të veçantë, sipas çdo viti dhe për të marrë një kopje nga akti, duhet të dihej të paktën viti i martesës. L.M. nuk mbante mend vitin e saktë të martesës

dhe për këtë arsye kërkimi ishte shumë i vështirë. Për të gjetur vitin e martesës duhet të merreshin të dhëna nga regjistrat e komunës Kashar.

Mbas kontaktimit të punonjës së zyrës së gjëndjes civile të komunës Kashar dhe kontrollit të regjistrat themeltar të shtetasve në numrin rendor të familjes së L.M., u konstatua që kjo familje kishte ardhur nga Kamza dhe martesë ishte bërë në vitin 1986. Morrëm datën e saktë të martesës dhe numrin e aktit të martesës. Me këtë informacion u drejtuam në zyrën e arkivit të Prefekturës Tiranë dhe më në fund tërhoqëm çertifikatën e martesës, të plotësuar me të gjitha të dhënat.

Kjo anomali ishte krijuar për shkak se gjatë transferimi fillestar të familjes, punonjësi i gjëndjes civile nuk kishte dërguar në zyrën e vëndbanimit të ri, edhe datën dhe numrin e aktit të martesës, sipas detyrimit ligjor. Për këtë arsye, në çdo transferim të mëvonshëm, mungonte ky in-



formacion.

Mbas marrjes së certifikatës së martesës, TLAS ka filluar procedurat gjyqësore për zgjidhjen e martesës së çiftit dhe marrjen e kujdestarisë së fëmijës nga ana e nënës. Ndihma e TLAS për plotësimin e të gjithë dokumentacionit të nevojshëm për gjykatën ishte e domosdoshme, sepse L.M. nuk mund ta realizonte e vetme këtë detyrë.

Elvira DERVISHI
Këshilltare e TLAS

VULLNETI SHTETËROR, AKTORI KRYESOR NË ZGJIDHJEN PËRFUNDIMTARE TË PROBLEMIT TË REGJISTRIMIT TË LINDJEVE

Regjistrimi i lindjes së fëmijës, është e drejta fillestare që një fëmijë gëzon, duke përfaqësuar regjistrimin zyrtar të ekzistencës së fëmijës, dhe duke siguruar në këtë mënyrë të drejtën e identitetit, emrit dhe kombësisë. Ajo lidhet ngushtësisht me një numër të madh të drejtash shoqërore, ekonomike dhe politike. Nëpërmjet njohjes ligjore



që shteti ofron, regjistrimi i fëmijës i siguron atij një gamë shumë të madhe mundësish dhe shërbimesh, duke përfshirë edukimin, shëndetësinë, mbrojtjen dhe pjesëmarrjen. Regjistrimi i lindjes gjithashtu u siguron autoriteteve shtetërore informacion, nëpërmjet të cilit ata arrijnë të planifikojnë, zbatojnë, realizojnë dhe hartojnë programe dhe politika efikase. Në këtë mënyrë regjistrimi i lindjeve luan një rol të rëndësishëm në mbrojtjen dhe realizimin e të drejtave njerëzore dhe në kontribumin në një shoqëri që funksionon efektivisht.

Shërbimi i regjistrimit të lindjeve



përfshin veprimet politike, alokim të burimeve, procedura dhe rregulla administrative dhe ligjore. Qeveria si mbajtëse e këtij detyrimi është përgjegjëse për realizimin e të drejtave të fëmijëve duke përfshirë dhe realizimin e regjistrimit të lindjeve. Vullneti politik dhe alokimi i burimeve luajnë rol në përcaktimin e praktikave administrative, krijimin dhe zbatimin e legjislacionit dhe përpjekjet për të nxitur interesimin e popullsisë për t'u regjistruar.

Një mungesë e vullnetit politik mund të jetë rezultat i ndërgjegjësimit të ulët i qeverisë dhe hartuesve të politikave, të rëndësisë dhe vlerës së regjistrimit të lindjeve si një e drejtë njerëzore dhe e rolit të tij thelbësor në një shoqëri demokratike. Vullneti i pakët politik për regjistrimin e lindjeve vjen si rezultat i një interesi të ulët për regjistrimin e lindjeve prej popullsisë, kryesisht të varfër. Vullneti politik është pengesa kryesore dhe burimi i shumë pengesave të tjera duke përfshirë alokim të pamjaft-

tueshëm të burimeve, mungesa e legjislacionit, zbatim i dobët i tij, staf i patrajnuar dhe i keq paguar etj.

Këto pengesa administrative të krijuara nga procedura të komplikuar dhe nga një administratë jo efektive, e patrajnuar dhe e papaguar ndikojnë më tepër te grupet e marxhinalizuara të shoqërisë.

Ligji “Për gjendjen civile” i miratuar në datë 10.10.2002, me gjithë ndryshimet përkatëse, përcakton rregulla, kërkesa dhe se kujt i drejtohet. Ligji kërkon pasjen e dokumentacionit të caktuar apo realizimit të procesit nëpërmjet një procedure, duke paraqitur një vështirësi të madhe ndaj personave që nuk disponojnë dokumentacion apo nuk ndjekin procedurën brenda afateve ligjore. Një pengesë e konsiderueshme është parashikimi i një afati ligjor për regjistrim dhe gjobën në rast vonese, në këto raste ligji krijon ndërlikime të tepërta duke krijuar pengesa për procesin duke mos qenë aspak efikas.

Kur një shtet nuk arrin të garantojë regjistrimin e plotë të popullsisë, atëhere pasojat do të jenë nga njëra anë fëmijëve të paregjistruar u mohohen një sërë të drejtash njerëzore dhe ata përjashtohen nga sistemi i përfitimeve të nevojshme për rritjen dhe zhvillimin e tyre dhe nga ana tjetër qeveritë në mungesë të regjistrimit të saktë të popullsisë nuk mund të planifikojnë saktësisht apo t'u ofrojnë shërbime fëmijëve, të cilët kanë nevojë.

Për arritjen e realizimit të regjistrimit të lindjeve, TLAS synon përmirësimin e ligjit për





gjendjen civile. Përveç një pune të madhe që TLAS po kryen për regjistrimin e lindjeve nëpërmjet procedurave gjyqësore me objekt "konfirmimin e faktit të lindjes së fëmijës", nga ana tjetër zbutja e fenomenit do të vinte dhe si rezultat i lehtësimit të procedurave gjyqësore duke i përjashtuar ato prej parashikimit ligjor. TLAS prej kohësh është i angazhuar në këtë iniciativë duke bashkëpunuar me institucione të ndryshme. Përfundimi i procedurave gjyqësore me objekt "konfirmimin e faktit të lindjes së fëmijës", ka të bëjë me regjistrimin e personit në regjistrat e Zyrave të Gjendjeve Civile dhe përfitimit

të çertifikatës personale, duke përfshirë në të të dhënat personale të individit.

Duke u bazuar dhe në mjaft instrumenta ligjorë ndërkombëtarë si mbrojtës të të drejtave të njeriut të sistemit Europian, apo që i përkasin OKB, detyrimi për të hartuar ligje të posaçme dhe efektiv nuk është vetëm kombëtar, por mbi të gjitha edhe një detyrim ndërkombëtar, të cilin shteti shqiptar e ka marrë përsipër në arritjen e standarteve të barabarta me ato të vendeve të tjera.

Ligji "Për gjendjen civile" i miratuar në vitin 2002 u hartua me qëllimin e eliminimit të abuzimeve të individëve dhe të institucioneve, duke çuar në ndërlikimin e procedurës së regjistrimit të fëmijëve nëpër regjistrat e gjendjeve civile. Rezultati i parashikuar prej tij ishte përfshirja e institucionit gjyqësor në këtë proces. Realiteti tregoi se synimi për të shmangur abuzimet çoi në rritjen e burokracisë së procesit, duke bërë që numri i i deklarimi


meve të lindjeve prej prindërve dhe i vendimeve gjyqësore në lidhje me të të jetë tepër i lartë. Kjo procedurë shoqërohet edhe me shpenzime të larta, pa përmendur gjobën, që duhet paguar, por duke marrë parasysh shpenzimet, që do të kërkonte avokati në përfaqësimin e rastit në gjykatë. Një familje, e cila ka lënë pas dore regjistrimin e fëmijës dhe duke u informuar më pas se procedura kërkon dhe përfshirjen e gjykatës, do ta kishte më të lehtë të mos përballej me gjykatën, e cila krijon një impakt jo të këndshëm te individ, nga njëra anë, dhe shpenzimet e tjera do të shoqëronin këtë proces, si pagesa e avokatit apo transporti, pasi shumë familje, të cilat nuk kanë deklaruar lindjen jetojnë larg gjykatës, në periferi të qyteteve, por dhe shpenzimi kohor nga ana tjetër është i rëndësishëm.

Përvoja e TLAS tregon se kjo masë nuk ka qënë aspak efektive. Numri i rasteve të regjistrimit të lindjeve është tepër i lartë dhe nuk ka nxitur uljen e tyre, që do të thotë se problemi duhet zgjid-



hur në themel dhe jo nëpërmjet masave që nxisin burokracinë dhe që nuk çojnë aspak në realizimin e qëllimit të ligjit.

Ndryshimet që janë paraqitur në ligjin "Për gjendjen civile" të vitit 2002, lehtësojnë tepër procesin e deklarimit të lindjes së fëmijës. Institucioni shëndetësor bashkëpunon në mënyrë të drejtëpërdrejtë me Zyrën e Gjendjes Civile, ku në të cilën më pas realizohet regjistrimi i fëmijës, hedhja e të dhënave përkatëse të individit në regjistrin përkatës. Procedura gjyqësore duhet të mos përfshihet më



HISTORI E VËRTETË

Klientja M.S u drejtua në zyrat e TLAS, për të marrë ndihmë ligjore përse i përket të drejtës së saj për të përfituar pension pleqërie. Klientja i ka drejtuar një kërkesë Institutit të Sigurimeve Shoqërore për të përfituar pension pleqërie, e cila i është refuzuar prej Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore me arsyetimin se klientja figuron në regjistrin themeltar të vjetërsisë në punë me emër ndryshe ndërsa mbiemri është i njëjti, Inicialet e saj janë M.S ndërkohë rezulton me inicialet Q.S. Klientja në çertifikatën e lindjes së gjendjes civile të Komunës, rezulton me emrin M. S. dhe se duhet bërë njohja në rrugë ligjore se bëhet fjalë për të njëjtin person.

Klientja M.S. ka filluar punën në kooperativën bujqësore në vitin 1959, kur ajo ishte në një moshë të mitur deri në mbylljen e kooperativës bujqësore në vitin 1990, siç rezulton nga vërtetimi "për vjetërsinë në punë për ish-anëtarët e kooperativave bujqësore" të lëshuar nga Insti-

në këtë proces, e cila nuk është zgjidhje por vetëm ndërlirim. Ndryshimi i ligjit do të sillte një bashkëpunim më të mirë të institucioneve përkatëse të përfshira në të dhe të rezultatit final atë të lehtësimit të procedurës së regjistrimit të fëmijës dhe si rrjedhojë regjistrimin e popullsisë dhe përfshirjen e të dhënave të tyre në regjistrat e gjendjeve civile. Këto ndryshime do të ndodhnin vetëm duke u mbështetur në angazhimin politik dhe vullnetin e mirë të ligjvënësit nëpërmjet ndërgjegjësimit të rëndësisë thelbësore, që mbart ky proces.

Anisa HAXHIA
Këshilltare paraligjore/Avokat
e TLAS

tuti i Sigurimeve Shoqërore. Që prej vitit 1993 deri në 2007, ajo është siguruar si e vetëpunësuar në bujqësi, siç vërtetohet nga vërtetimi i Institutit të Sigurimeve Shoqërore sipas të dhënave të regjistrit themeltar.

Dokumenti vërtetim “për vjetërsinë në punë për ish-anëtarët e kooperativave bujqësore” të lëshuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, i vitit 2008, përmban pasaktësi të emrit të klientes M.S. bazuar në regjistrin themeltar të vjetërsisë në punë, ndërkohë sipas certifikatës së lindjes së gjendjes civile të Komunës emri i saj i saktë është M.S.

Në regjistrat e Institutit të Sigurimeve Shoqërore del dhe një pasaktësi tjetër. Ky vërtetim gjithashtu nuk përmban të gjitha vitet e punës që klientja ka punuar që prej vitit 1959 deri në 1990 dhe shumë vite të punës nuk janë shënuar.

E vetmja rrugë për t'i dhënë problemit zgjidhje të drejtë dhe ligjore është vërtetimi i faktit se klientja me inicialet M.S është i njëjti person që mban inicialet Q.Sh dhe se ajo realisht ka punu-



ar në kooperaivën bujqësore nga viti 1959 deri në vitin 1990. Kjo zgjidhje jepet në K.Pr.C.

Sipas nenit 388 të K. Pr.C paragrafi i tretë, kërkohet që “kur nga një fakt varet lindja, ndryshimi ose shuarja e të drejtave personale apo pasurore të një personi dhe akti që e vërteton atë është zhdukur, ka humbur dhe nuk mund të bëhet përsëri ose nuk mund të merret me ndonjë rrugë tjetër, personi i interesuar ka të drejtë të kërkojë që fakti të vërtetohet me vendim të gjykatës së shkallës së parë. Kërkesa paraqitet në gjykatën e shkallës së parë, në territorin e së cilës ka banim



kërkuesi. Në mënyrën e treguar më sipër mund të kërkohej korigjimi i gabimeve të akteve të treguara në paragrafin e parë të këtij neni".

Pasaktësia e këtij vërtetimi do të provohet me prova shkresore –me vërtetimin për vjetërsinë në punë për ish-anëtarët e kooperativave bujqësore" të lëshuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, e vitit 2008, vërtetimin për të vetëpunësuarit në bujqësi e lëshuar prej Institutit të Sigurimeve Shoqërore të vitit 2007, çertifikatën e lindjes së gjendjes civile të Komunës, vërtetimin e Komunës, në të cilën kryetari i Komunës vërteton se klientja M.S. është banore e vjetër në

këtë Komunë, vërtetimin e kryetarit të fshatit, ku ajo banon, ku deklarohet i njëjti fakt, se klientja është banore e këtij fshati. Këtë pretendim ajo e bazon dhe e provon dhe me thëniet e majft dëshmitarëve, të cilët kanë punuar me të, duke përfshirë dhe ish-brigadier i Kooperativës Bujqësore dhe të cilët u treguan të gatshëm që të dëshmojnë për vitet e punës së klientes.

Nga këto prova rezulton plotësisht se vërtetimi për vjetërsinë në punë për ish-anëtarët e kooperativave bujqësore" të lëshuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, dt 2008, përmban pasaktësi në emrin e klientes dhe të viteve të saj të punës në kooperativë.

Klientja nuk mund ta provojë pretendimin në rrugë tjetër veç asaj gjyqësore dhe nga vërtetimi i tij rrjedhin pasoja juridike që lidhen me efektet e realizimit të drejtave dhe detyrimeve të saj dhe interesave të ligjshme.

Anisa HAXHIA
Keshilltare paraligjore/Avokat
e TLAS

KUJDESTARIA E POSAÇME

Një nga konceptet më të rëndësishme që është parashikuar edhe në Kodin e Familjes është “Kujdestaria”. Vetë termi kujdestari përfshin a) kujdestarinë e posaçme dhe b) kujdestaria mbi personat që u është hequr ose u është kufizuar zotësia për të vepruar.

Janë pikërisht rastet e kujdestarisë së posaçme që hasen më shumë në gjykatat Shqiptare.

Kujdestaria e posaçme mund të vendoset vetëm në disa raste taksative të parashikuara nga ligji pra nga Kodi i Familjes, sipas nenit 274 të Kodit të Familjes gjykata mund të vendosë caktimin e një kujdestari të posaçëm kur:


a) ka konflikt interesash midis të miturit dhe prindërve ose midis të miturit dhe kujdes-



tarit të tij, si dhe kur midis tyre duhet të kryhet një veprim juridik;

b) ka konflikt interesash midis të miturve, vëllezër dhe motra, që kanë të njëjtin kujdestar ose kur duhet të kryhet një veprim juridik midis tyre;

c) për shkak sëmundjeje ose për shkaqe të tjera, kujdestari i caktuar pengohet të kryejë një veprim të caktuar ose të japë pëlqimin për kryerjen e një veprimi.



Pra siç parashikohet edhe në paragrafin e mësipërm kujdestaria e posaçme mund të vendoset vetëm për rastet e mësipërme, kryesisht kur ka konflikt pasuror midis personave që janë në kujdestari ose kur njëri nga personat që do të përfshihet në veprimin juridik është i mitur dhe nuk mund ti kryejë vetë këto veprime juridike pikërisht për shkak të moshës së tij të mitur.

Kujdestari i posaçëm caktohet nga gjykata mbi bazën e kërkesës së prindit, të kujdestarit, së të afërmeve të të miturit, të miturit që ka mbushur

moshën katërmëdhjetë vjeç dhe personave të interesuar. Caktimi i kujdestarit të posaçëm sipas Kodit të Familjes është kompetencë vetëm e gjykatës dhe së bashku me caktimin e kujdestarit të posaçëm gjykata cakton edhe kufijtë e detyrave dhe të drejtave të kujdestarit, sipas rrethanave të çdo rasti të veçantë.

Pra kujdestari i posaçëm duhet të kryejë vetëm ato veprime për të cilat është vendosur kujdestaria e posaçme dhe asnjëherë ti mos kalojë kufijtë e vendosur nga gjykata, dhe të veprojë gjithmonë në interes të personit të cilin ka marrë në kujdestari.

Gjithashtu Kodi i Familjes me qëllim që të mbrojë sa më mirë interesat e personit që vendoset në kujdestari të posaçme ka parashikuar disa raste të veçanta, pra sipas nenit 278 të Kodit të Familjes:

a) Kujdestari i posaçëm për-

faqëson të miturin në rastet kur interesi i tij është në konflikt me interesin e kujdestarit.

b) Kur kujdestari i posaçëm ndodhet në konflikt interesash me të miturin, gjyqtari emëron një kujdestar tjetër.

c) Kujdestari i posaçëm duhet të kërkojë caktimin e një kujdestari të ri në çastin kur kujdestari nuk kryen ose braktis detyrën. Kujdestari i posaçëm kujdeset për të miturin, e përfaqëson atë dhe mund të kryejë të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me ruajtjen dhe administrimin e pasurisë në raste urgjente.

d) Dhuruesi ose personi që disponon me testament në favor të një të mituri, edhe pse ky i fundit është nën përgjegjësinë e prindërve të tij, mund t'i caktojë atij një kujdestar të posaçme për pranimin dhe administrimin e pasurisë së dhuruar ose të lënë atij me testament.

Kujdestaria e posaçme mbar-



on kur pushojnë shkaqet për të cilat ajo është vendosur sipas rastit konkret, gjithashtu mbarimi i kujdestarisë së posaçme bëhet me kërkesën e personave që kanë kërkuar vendosjen e saj.

Adrian SHEGA
Këshilltar paraligjor/ Avokat
i TLAS

VËRTETIMI I FAKTIT I VITEVE TË PUNËS PËR EFEKT PENSIONI

Vitet e fundit po vihen re mjaft probleme në lidhje me pensionin e pleqërisë, për personat të cilët e kanë mbushur moshën për pension pleqërie, por problemet që hasin këta persona në momentin e paraqitjes pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore janë pikërisht mangësitë ose gabimet e plotësuara në librezat e tyre të punës.

Ky problem është mjaft i rëndësishëm për këta per-

sona të cilët kanë mbushur moshën për pension pleqërie por pikërisht fakti i mangësive në dokumentat e tyre i bën ata që të mos e përfitojnë këtë pension.

Një rast i tillë u paraqit edhe në zyrën tonë, klientja H.C kërkonte vërtetimin e faktit të qënies në marrëdhënie pune në K E K P, për një periudhë prej 7 vjetësh ku ajo kishte punuar si punëtore dhe në librezën e saj të punës ishte shënuar viti në të cilin ajo kishte filluar punë pranë këtij institucioni, por nuk ishte shënuar viti në të cilin ajo kishte ndërprerë marrëdhëniet e punës dhe pikërisht për këtë fakt Instituti i Sigurimeve Shoqërore nuk ia njihte këto vite të sipërpërmendura si vite pune, duke i mohuar në këtë mënyrë përfitimin e pensionit të pleqërisë.

Pasi u paraqit në Zyrën tonë dhe pasi u diskutua çështja nga këshilltari i projektit



u kërkuar dokumentat e nevojshëm që duheshin për të bërë të mundur pikërisht vërtetimin e faktit të qënies së klientes H.C në marrëdhënie pune pranë K E K P për një periudhë prej 7 vjetësh.

Në rastin e paraqitur në Zyrën tonë klientja H.C dispononte dokumentin bazë “librezë pune”, por dokumentat e tjerë që vërtetonin qënien e saj në marrëdhënie pune ishin djegur gjatë trazirave të vitit 1997. Mbas diskutimit me avokatët e Zyrës u mendua që çështja të paraqitej në gjykatë me objekt “Vërtetim Fakti” ku neni 388 I Kodit të Procedurës Civile shprehet: “Kur nga një fakt varet lindja, ndryshimi ose shuarja e të drejtave personale apo pasurore të një personi dhe akti që vërteton atë është zhdukur, ka humbur dhe nuk mund të bëhet përsëri ose nuk mund të merret me ndonjë rrugë tjetër, personi i intere-



suar ka të drejtë të kërkojë që fakti të vërtetohet me vendim të gjykatës së shkallës së parë”.

Në mënyrën e treguar më sipër mund të kërkohet edhe korrigjimi i gabimeve të akteve të treguara në paragrafin më sipër.

Në kërkesën për vërtetimin e fakteve duhet të kërkohet:

- a. qëllimi për të cilin kërkuesi paraqit kërkesën për vërtetimin e faktit të caktuar;
- b. shkaqet për të cilat nuk



mund të merret akti ose për të cilët nuk është mundur që akti të bëhet përsëri;
c. provat me të cilat do të provohet si shkaku, për të cilin nuk është e mundur të merret akti ose ky akt nuk mund të bëhet përsëri, ashtu edhe fakti që kërkohet të vërtetohet. U procedua për mbledhjen e të gjithë dokumentave të nevojshëm që do të shërbenin në këtë rast duke u marrë të gjithë doku-

mentat e domosdoshëm. Pasi u mbledhën këto dokumenta u përpilua kërkesa për në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe u paraqit kërkesa në gjykatë.

Pas disa seancave gjyqësore gjykata arriti në përfundimin se e gjente të drejtë dhe të bazuar në ligj kërkesën e bërë nga klientes H.C duke i dhënë të drejtë për kërkimin e saj. Në këto kushte u arrit në përfundimin e kërkuar nga klienti H.C dhe u vlerësua puna e bërë nga Zyra për Shërbimin Ligjor Falas për zgjidhjen e kësaj çështje.

Adrian SHEGA
Këshilltar paraligjor/ Avokat
i TLAS

Shërbimi Ligjor Falas Tiranë

Nr. 1 / 2008

TLAS

